



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.262/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Prizren paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.262/2017, e datës 19.10.2017, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Vetëvendosje (VV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 19.10.2017 nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilën pretendon se me datën 18 tetor 2017, duke ushtruar të drejtën për bërjen e fushatës zgjedhore në “Sheshin e Lidhjes” në Prizren( në përputhje me pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e KK Prizren nr.04353/01-139653 e Datës 06.10.2017), grupi i tyre i të rinjëve është ballafaquar me ushtrim presioni me tendencë dhune nga ana e simpatizantëve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, të cilët kanë kërkuar që të largojnë shtandin e tyre me materialin e reklamuesë zgjedhore nga vendi dhe zona ku kanë qenë të vendosur, të cilën për këtë janë detyruar ti ftojnë organet policore dhe inspektoratin në kuptim të mbrojtjes të drejtës së tyre për bërje fushatë zgjedhore në lokacionin e cekur në ankesë. Parashtruesi i ankesës pretendon se tendenca e aplikimit të dhunë është në kundërshtim me të drejtat demokratike dhe të lirisë për bërjen e fushatës.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur Pëlqimin për vendosjen e shtandit mobil të partisë së tyre politike AKR, Dega në Prizren, i cili pëlqim theksojnë se ju jep të drejtën për ushtrim fushate përmes këtij shtandi deri më datën 20.10.2017.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të datës 20.10.2017, informon PZAP-ën se aktivistët e subjektit të tyre politik nuk kanë ushtruar presion as tentim dhune ndaj aktivistëve të AKR-së në lokacionin e caktuar. Aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) pasi kanë paralajmëruar tubimin në përputhje me legjislacionin në fuqi aty afër saj nuk kanë gjetur tendën e vendosur nga AKR, me të cilën përmes asaj tende kanë

bërë çrregullimin e tubimit publik përmes fjalëve ofenduese, muzikës me zë të tepër të lartë gjë që ka penguar pa masë rrjedhën e tubimit. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se vendosja e tendës pa lajmëruar KKZ-në përbën shkelje të LZP-së si dhe sipas praktikës gjyqësore të PZAP-së vendosja e tendës edhe me pëlqim të komunës përbën shkelje të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme (LZP). Lidhur me këtë subjekti politik LVV në përgjigjen e tyre thekson se aktivistët e tyre në Prizren kanë komunikuar me aktivistët e AKR-së për të ia lëshuar vendin e rezervuar nga VV e Prizrenit sikurse kanë paraqitur provat ankesës ZL.Anr.254/2017. Më tej theksojnë se aktivistët e AKR-së nuk kanë tërhequr tendën edhe pas lutjeve që iu është bërë nga aktivistët e LVV-së. Subjekti politik LVV në vazhdim të përgjigjes theksojnë se pas lajmërimit të tubimit me kohë nga KKZ e Prizrenit, Policia e Kosovës sipas ligjit ka qenë e detyruar të jetë ty dhe aktivistët e tyre e kanë thirrur policinë, por policia nuk ka ndërmarr asnjë veprim për ti larguar aktivistët e AKR-së. Në këtë rast nuk ka pasur kurrfarë tentimi për dhunë apo presion, andaj ka propozuar që ankesa të refuzohet.

Përgjigjes në ankesë iu kanë bashkangjitur Pëlqimin e pronarit privat në cilësi të provës materiale.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstatohet se :

#### **Ankesa është e pa bazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik Vetëvendosje, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 par 1 pika I të LZP-së , për arsye se shkeljet e pretenduara në ankesë nuk ka të bëjë me presion dhe tentim dhune gjatë fushatës zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale 2017. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë ashtu siç parashihet me nenin 117 par.3 të LZP-së në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr. 262/2017 me datën 20.10.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylejmani



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.